



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo  
Republic of Kosovo



Komuna e Istog  
Opština Istok  
Istog Municipality

<http://kk.rks-gov.net/istog/>

Tel: 038/200 438 14

---

## KUVENDI I KOMUNËS/SKUPŠTINA OPŠTINE/MUNICIPAL ASSEMBLY ISTOG

---

### PROCESVERBAL

Nga mbledhja e 4<sup>-te</sup> e Legjislacionit të VI<sup>-te</sup> të Kuvendit të Komunës së Istogut, mbajtur më: 29.03.2018, në Sallën e Kuvendit të Komunës në Istog, filluar me punë në ora 10:00.

Në mbledhje ishin të pranishëm këta këshilltarë:

- |                           |                            |
|---------------------------|----------------------------|
| 1. Qaush Balaj, LDK;      | 16. Ardita Idrizaj, AAK;   |
| 2. Enver Rugova, LDK;     | 17. Jehonë Haxhijaj, AAK;  |
| 3. Zenel Shatri, LDK;     | 18. Arben Kabashi, PDK;    |
| 4. Besa Ferati, LDK;      | 19. Lulzim Shoshi, PDK;    |
| 5. Naim Behlulaj, LDK;    | 20. Ajshe Metaj, PDK;      |
| 6. Luljeta Zeqiraj, LDK;  | 21. Mirushe Sadikaj, PDK;  |
| 7. Haki Podrimaj, LDK;    | 22. Agron Avdijaj, VV;     |
| 8. Selajdin Bytyqi, LDK;  | 23. Lavdije Bujupaj, VV;   |
| 9. Hajrush Shoshi, LDK;   | 24. Arif Elshani, AE;      |
| 10. Valbona Demaj, LDK;   | 25. Radoš Repanović, SL;   |
| 11. Edona Lubeniqi, LDK;  | 26. Radenko Belošević, RB; |
| 12. Naim Imeraj, AAK;     | 27. Slaviša Maliković, SM. |
| 13. Negjmedin Balaj, AAK; |                            |
| 14. Muhamet Ukaj, AAK;    |                            |
| 15. Eliot Kukiqi, AAK;    |                            |

Mbledhja ishte e hapur dhe në mbledhje ishin të pranishëm edhe: Kryetari i Komunës z. Haki Rugova, përfaqësues të OSBE-së, KFOR-it, përfaqësues të shoqërisë civile, mediave, disa qytetarë etj (lista e nënshkrimeve të evidencës së pjesëmarrjes është pjesë përbërëse e këtij procesverbali dhe e njëjtë gjendet në dosje: "shembulli 1")

(Ecuria e tërë mbledhjes është xhiruar edhe CD-t e xhirimit gjenden në dosje: "shembulli 2").

Mbledhjen e kryesoi, Kryesuesi i Kuvendit z. Qaush Balaj.

Për këtë mbledhje u propozua ky:

## R e n d d i t e

1. Arsyetimi i mungesave në mbledhje;
2. Miratimi i procesverbaleve nga mbledhjet e kaluara;
3. Dhenja e betimit të anëtarit të kuvendit komunal nga radhët e LDK-së,
4. Marrja e vendimit për formimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi,
5. Shpallja në diskutim publik i Projekt – Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba,
6. Marrja e vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave dhe për ankesa,
7. Marrja e vendimit për formimin e komisionit vlerësuese për dhenjën e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim dhe formimin e komisionit për ankesa,
8. Shqyrtimi i raportit përfundimtar financiar për vitin fiskal 2017,
9. Anulimi i vendimeve të Kuvendit të komunës me numër, 01Nr.65/2017, 01Nr.66/2017, 01Nr.67/2017, dhe 01Nr.68/2017 të datës 05.05.2017.
10. Marrja e vendimit për dhenjën në shfrytëzim afate shkurtër të pronës Komunale me ankand publik për njësit kadastrale. Nr.00256-2, Nr.00074-10, Nr.00074-7, Nr.00074-6, Nr.00074-11, Z.K Vrellë, dhe njësive kadastrale Nr.00028-95, Nr.00028-94, Nr.00028-93dhe Nr.00028-92, Z.K Cerrcë.

Kryesuesi - i kalon fjalën z. Arben Kanashi.

Arben Kabashi, PDK – përshëndet te gjithë te pranishmit, kërkon qe te ngritet një komision për gjendjen aktuale te pronave Komunale dhe prej tyre sa do të epen në shfrytëzim, që të mos ngutemi të marrim hapa konkret pa e ditur dëmin që është bërë që disa vite, është bëre kjo temë paksa tabu që e kemi rrehë shumë herë që kemi reaguar për to disa here andaj unë kërkoj formimin e një komisioni më inspektor të komunës dhe anëtar të kuvendit të bëhet inspektimi në atë pjesë që është ndarë në shumë parcela, propozon të hy si pika e 9 e rendittë ditës.

Nënkyetari i Komunës – përshëndete të gjithë të pranishmit, nuk ka nevojë të bëhet një komision i tillë, pasi që për dhenjen e këtyre pronave në shfrytëzim do të jetë një procedurë qe do të shkoj përmes ankandit publik. Në fillim do të shpallet ankandi publik dhe pastaj komisioni për vlerësim do të merret me procedurat tjera, ashtu siç parashihet me ligj.

Arban Kabashi, PDK - për gjendjen e atyre prona ku do të jepë në shfrytëzim sot, po i bijë që pika e dhjetë ta mbulojë pikën e nëntë për shfuqizimin e vendimeve të vitit paraprak. Po kërkoj që si pikë të rendit të ditës pika e 11 të bëhet një komision për vlerësimin e pronave komunale, në bazë edhe të ekspertëve sa kam mundur ta vërej ka pasur gjetje arkeologjike të me hershme në ato prona në mesë të fshatit Lubozhdë dhe Cerrcë ku është gurthyesi aty thjeshtë në po provojmë ta bëjmë një inspektim në bazë këtij komisioni sie e propozova prej anëtarëve të Kuvendit bashke me ekzekutivin.

Naim Imeraj, AAK- përshëndet të gjithë të pranishmit, fakti që gjendja aktuale e parcelave të cilat në do të diskutojmë, në pikën 10 do të marrim vendime, ku nuk është ajo e cila është e shkruar në fletë posedime, andaj fakti që ne po thirrëm në një procedurë që ka të bëj me ankand publik për parcelat të cilat veç sa e kanë një gjendje të ndërruar, propozimin e kolegut Kabashi e konsideroj si të qëndrueshëm edhe për AAK-në është i pranishëm.

Lulzim Shoshi, PDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, nuk është se grupi i PDK-së është konsultuar për atë që tha Arbeni kërkesa e kësaj pikë për rend ditë është i z. Kabashi.

Agron Avdia, VV - përshëndet të gjithë të pranishmit, edhe ne si VV konsiderojmë që propozimi i Arbenit ka një arsyе dhe në e përkrahim mendimin e ti, për rend ditë.

Arif Elshani, IQ - përshëndet të gjithë të pranishmit, kemi filluar një mandat të ri dhe kisha kërkuar nga ju që jeni kryesuesi i të gjithë anëtarëve të Kuvendit pa pavarsi prej se cilës parti shkon. Arbeni të njëjtën e ka kërkuar edhe mandatin e kaluar ku në e kemi përkrahur, unë e përkrahi dhe mendimi im është personale që nëse në e formojmë një komision të qesim sot në rend ditë formimin e komisionit asgjë të keq nuk bëjmë, e përkrahi dhe e inkurajoj Arbenin për guximin që është në gjendje të bëjë propozime.

Enver Rugova, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, në e kemi të njëjtën qështje mendova që po shtrohet qeshja e pronave në Dubravë dhe Kusar që kemi për dhëni e tokave bujqësore me duket që është e kryer nëse merret si justifikim, në e dimë dhe jetojmë këto lokacione që i përmendet në rendin e ditës me hartën arkeologjike të Kosovës dhe me gjetje të deri më tashmë që janë zhvilluar në fshatin Lubozhdë në lugun e Vrellës dhe tutje lokacionet deri më tanë që i ka dhënë Ministria, agjensioni i minierave dhe mineraleve që është kompetent për ato, nuk ka gjetje arkeologjike dhe nuk ka komplikime tu i shqyrtuar këto gjëra dhe pikën e dhjetë që mos ta bëjmë politike se ngastrat kommunale të stere verifikuara tash e disa herë që dy vjet merremi me këtë kështu që nuk kishim humbur shumë kohë. Komuna e Istogut ka mjaftë prona kommunale.

**Kryesuesi - hedh në votim propozimin e Arbenit. Kush është që të shtohet kjo pikë e rendit të ditës**

**Për 10 vota**

**Kundër 13 vota**

**Abstenimi 3 vota**

**Me shumicë votash nga anëtaret e Kuvendit nuk kalon propozimi i Arben Kabashit që të formohet një komision për mbikëqyrjen e pronave të Kuvendit të komunës.**

**Hedhë në miratim rendin e ditës**

**Për 20 vota**

**Kundër 2 vota**

**Kuvendi i Komunës më shumicë votash vendosi:**

**Miratohet rendi i ditës.**

**Shqyrtimi i pikës 1.**

Në mbledhje ishin të pranishëm të gjithë anëtaret e Kuvendit Komunal.

**Shqyrtimi i pikës 2.**

U shqyrtuan procesverbalet nga mbledhja e kaluar e kuvendit (të gjithë anëtarëve të kuvendit iu është shpërndarë procesverbali nga mbledhja e kaluar dhe e njëjta gjendet në dosje: "shembulli 3"). Fjalën e kërkon z. Arif Elshani.

Arif Elshani, IQ - kam kërkuar një pyetje nga ana juaj për zëvendës kryesuesin për komunitete, siç kam kërkuar një përgjegjës nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal, unë kam përgjigje nga MAPL-ja. Në mbledhjen e kaluar kam propozuar që në Komitetin për Politikë e Financa kam propozuar që të jete një anëtar nga VV -ja Edhe pse në e kemi një marrëveshje për bashkëpunim por propozimin ton e hedhet poshtë. Por anëtarin e Kuvendit nga lista serbe Radosh Repanoviq Si po na klasifikoni mua dhe anëtaret e tjerë të Kuvendit kur një tjetër të kualifikon, si po e ndini ju veten ku të tjerët duhet që kërkesa e tyre të aprovohet, ndërsa kërkesa jon dhe VV nuk aprovohet nuk po me pëlqen na as njëri të cilët nuk e kan pranuar propozimin tonë.

Kryetari i Komunës - pëershendet të gjithë të pranishmit, këto vendimi merren në Kuvend e jo nga kryetari kemi kërkuar interpretim nga Ministria dhe ku kanë dhënë përgjigje ku kanë ardhur dhe në na ka ardh ajo përgjigje, ju keni kërkuar përgjegje nga Ministria dhe atë përgjegje e kemi edhe ne dhe ju, por atë mbledhje nuk u murr aj vendim. Mundë tua lexojë përgjigjen e Ministris që ju ka drejtuar Kryesuesit që vendimi është marrë në Kuvend.

Arif Elshani, IQ - mua po me intereson që a kemi ne si Kuvend zëvendës kryesues të Kuvendit Komunal.

Kryesuesi i Kuvendit - ne nuk kemi zevendës Kryesuese të Kuvendit Komunal.  
Dhe lexon përgjegjen nga Ministria e Administratës së Pushtetit Lokal.

Radoš Repanović SL – kërkon sqarime rreth zëvendës kryesuesit për komunitet .

Kryetari i Komunës - Ministria kompetente ka bërë interpretimin për zëvendës kryesuesin për komunitete, janë thirrur në dokumente zyrtare. Dua ta përsëris prape nëse është vullneti i juia i Anëtarëve të Kuvendit që të kemi zëvendës kryesuesin për komunitete atëherë askush s'mund të na ndaloj sepse nuk do të jetë hera e parë për këtë ne kemi pasur zëvendës kryesuese për komunitete edhe mandatet e mëhershme. Në Kuvend çdo vendim që të merret kolonë në shqyrtim të ligjshmërisë nga Ministria përgjegjëse,

dhe ata na kthejnë një përgjigje se a është në pajtim me ligjin apo jo. Ministria na kanë dhënja një përgjigje.

Arif Elshani, IQ - ju thatë që ligji nuk e lëndon por ju anëtaret e Kuvendit me pru me iniciativën tonë një vendim të tillë mendojë që është shkelje ligjit, Ministria e ka dhëne një sqarim, nuk të inkurajoj që me dëshirën e dikujt të shkelet ligji.

Kryetari i Komunës - nuk e di nëse me kuptuat mirë, po e përsëris nëse MAPL thotë që nëse nuk bëni shkelje që e zgjedhin kryesuesin për komunitete të Kuvendit atëherë ju mundë të vendosni. Dhe kërkesën që e keni bërë ju për interpretim me keni akuzuar mua që e kam shkelur ligjin, unë nuk mund ta shkel ligjin me një vendim ku e merr Kuvendi.

Arif Elshani, IQ - e vërtet që kam jap deklaratë në portale dhe çdoherë do të japë, propozimi juaj ka qenë atë ditë dhe këtu po e thua nëse do me bë bene po i ki votat po nëse ka sqaruar ligji pse po humbim kohë për diçka që është sqaruar.

Naim Imeraj, AAK- për AAK-në është e qartë kjo është diskutuar kurë ka qenë pikë e rendit të ditës, ne jemi në pikën e rendit të ditës miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të kaluara dhe kisha lutur që të vazhdohet me këtë pikë të rendit të ditës përgjigjet nga Ministria linjë janë ardhur dhe nuk besoj që mundë të ketë Udhëzim Administrativ që është në kundërshtim me Ligjet.

Zenel Shatri, LDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, Këtu ligji e precizon shumë mirë vetëm dua të di a është ndër 10%, në vetëm humbje kohë kemi këtu duke debatuar për këtë temë interpretimi është dhënë kështu që procedojnë më tutje.

Pasi që nuk pati vërejtje në procesverbal, Kuvendi i Komunës shumicë votash me 23 për vendosi:

#### **Miratohet procesverbali i mbledhjes së kaluar pa vërejtje**

#### **Shqyrtimi i pikës 3**

**Kryesuesi** – njofton anëtaret e kuvendit me vendimin e KQZ-së për zëvendësimin nga radhët e LDK-së z. Lulzim Blakaj me z. Selajdin Bytyqi.

Pastaj fton z. Selajdin Bytyqi ta japë betimin dhe ta nënshkruaj deklaratën.

**Selajdin Bytyqi, LDK** - japë betimin si anëtar i kuvendit komunal, dhe nënshkruan deklaratën ( deklarata e nënshkruar gjendet në arkivin e kuvendit.)

#### **Shqyrtimi i pikës 4**

**Kryesuesi** – propozon që të vazhdohet me piken e katërt të rendit të ditës, Marrja e vendimit për formimin e Këshillave Komunale për Siguri në Bashkësi, fjalën ja kolonë Kryetarit të Komunës.

Kryetari i Komunës - sqaron procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të KKSBS-së, lexon emrat e anëtarëve,

Skënder Hasangjekaj, zyrtar - përshëndet të gjithë të pranishmit, bënë prezantimin e KKSBS-së.

Ajshe Metaj, PDK - përshëndet të gjithë të pranishmit, lidhur me listën e anëtarëve të KKSBS-së ne në KPF kemi pasur vetëm një anëtar mungonte dhe është debatuar për atë anëtar kurse tani janë hekur edhe dy, me Udhëzimin Administrativ u tha që në duhet tu përbahemi rregullave ose ligjeve dua të di cili kriter është marr a është kështu me i hekë ata apo duhet me u plotësua ata me anëtar tjerë apo si qëndron puna.

Skënder Hasangjekaj, zyrtar - atë ditë është marr vendim që kjo listë të shtohet, kamë marr për obligim që të pus Ministrin e Punëve të Brendshme se a mund të shtojmë, në udhëzimin administrativ 27/2010 listat paraprake ka qenë që është bazuar në Udhëzimin Administrativ para këtijë dhe është mbetur si numër i till 25 përgjigjen që kamë marrë decitivisht në nenin 4 përfaquesi për pylltari dhe drejtori i Shëndetësisë nuk parashihen me këtë udhëzim dhe është kërkuar nga në që ti hjekim nga ky Këshill.

Agron Avdija, VV - vetëm deshta të që për menagjim të kohës që herave tjera të prezanton kështu qartë siç ishte kjo e dyta në mënyr që mos me ngjallë konfuzionet me bë pyetje ne pasi që çoi kemi paqartësi.

**Kuvendi komunal më 26 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenime vendosi:**

**Që KKSBS-ja të ketë këtë përbërje prej 23 anëtarëve,**

**Miraton me shumicë votash.**

**(bashkangjitur vendimi i miratuar në Kuvend)**

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.15/2018	Data: 29.03.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë te nenin 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenin 40. paragrafi 40.2. pika e) të Ligjit për vetëqeverisjen lokale (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008), dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 5) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10, nenit 3. paragrafi 2. dhe nenit 4. të Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 të MBP-së dhe 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi, në mbledhjen e mbajtur me 29.03.2018, shqyrtoi Listën e propozuar nga Kryetari i Komunës për anëtar të Këshillit Komunale për Siguri në Bashkësi dhe mori këtë

**V E N D I M**  
**PËR FORMIMIN E KKSBS-SË**

1. Formohet Këshilli Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBS) në përbërje:

1. Haki Rugova, Kryetar i Komunës, Kryesues;
  2. Enver Gashi, Komandant i Stacionit Policor;
  3. Avni Gashi, Bashkësia Islame;
  4. Don Isak Dodës, Kisha Katolike,
  5. Jerej Nebojša Sekolić, përfaqësues i kishës ortodokse serbe,
  6. Xhafer Blakaj, Komuniteti Shqiptar;
  7. Svetlana Gjorić, Komuniteti serb;
  8. Enisa Čorrević, Komuniteti boshnjak;
  9. Ganuimer Shaqiri, Komuniteti romë;
  10. Ukë Dollci, Komuniteti egiptas;
  11. Radenko Belošević, nga Komitetit për Komunitete;
  12. Sanije Mavraj, Zyrtare për barazi gjinore;
  13. Agim Haxhaj, Drejtësor i Drejtoretat për Arsim;
  14. Zizë Bujupaj, Kryesuese e këshillit të prindërve të arsimit në komunë;
  15. Demë Maloku, Kapiten i FSK;
  16. Luljeta Shabaj, KLSP;
  17. Blendinela Shatri, EVSB;
  18. Skendr Hasangjekaj, Sektori i Emergjencave;
  19. Rasim Mahmuteviq, Zyra Komunale për komunitete dhe Kthim;
  20. Asdren Hasanaj, OJQ "LIRIA";
  21. Zeqir Mehmetaj, Radio "Fontana";
  22. Lumdita Idrizaj, HENDIKOS";
  23. Komuniteti i Biznesit;
2. KKSBS do të funksionojë dhe realizojë përgjegjësit e saj në pajtim me dispozitat e Udhëzimit Administrativ Nr.27/2012 të MBP-së dhe 03/2012 të MAPL-së për Këshillat Komunale për Siguri në Bashkësi.
  3. Mandati i Këshillit është i njëjtë me mandatin e anëtarëve të këtij Kuvendi.
  4. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tije në ueb faqen e komunës.
  5. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: anëtaret e KPF-së, MAPL, zyrtari për paga, mëditje dhe kompensime dhe një kopje në arkivin e zyrës së Kuvendit.

**KRYESUESI I KUVENDIT,**  
**z. Qaush Balaj**

## **Shqyrtimi i pikës 5**

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e pestë të rendit të ditës, Shpallja në diskutim publik i Projekt – Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba.

Nënkyetari i Komunës – prezantoi dhe sqaron procedurat rreth rregullores.

Kryesuesi - pasi që nuk ka diskutimi hedhim në miratim Shpallja në diskutim publik i Projekt – Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba.

**Miratohet unanimisht nga anëtaret e kuvendit Shpallja në diskutim publik i Projekt – Rregullores për taksa, ngarkesa dhe gjoba.**

## **Shqyrtimi i pikës 6**

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e gjashtë të rendit të ditës Marrja e vendimit për formimin e komisionit për ndarjen e bursave dhe për ankesa.

Zenel Shatri, LDK - ne e kemi bërë një ndryshim në këtë rregullore për ndarjen e bursave, por as kjo nuk është e rregulluar mirë apo kish bë që ta shqyrtojmë edhe një herë këtë rregullore, dhe pastaj ta bëjmë ndarjen e bursave.

Agron Avdijaj, VV - nl vitin e kaluar ka pasur ankesa edhe në kuptimin e sasis së përfituesve të bursave, komuna mundë të marrë një hap e ti kontaktojë bizneset që janë të gatshme të participojnë për bursa për studentë kjo kish ndikuar shumë pozitivisht edhe për përfomancën e komunës edhe njëkohsisht edhe ishin përkrahë me shumë studentët me thirrë një takim me pizneset dhe me prezentuar si ide po besoj që një pjes e tyre kanë me shprehë gadishmërin me dhënë kontribut finansiar ndërsa transferi i mjeteve mund të zgjedhet me vonë.

Kryetari i Komunës - kjo është ide e mirë z. Agron por ka disa biznese që i financojnë studentët dhe përgjedhjen e bëjnë vetë, ka raste kur bizneset kanë kërkuar nga ne ndonjë studentë. Këtu në Kuvend duhet ti ndiqen procedurat sipas Rregullores komisioni do të formohet nga kuvendi, ndërsa kjo me biznese nuk është ide e keqe që të thirren nëse ata do të kontribuan bashkë me ne që përgjedhjen me bë komisionet tona është në rregull, por ka donator që kan ardhur nga vendet e jashtme i ka marr disa studenta dhe nuk ka dashur që përgjedhja të jetë nga Komuna por ka bërë përgjedhjen e vetë. Por lartësia e bursës se di sa mundë të jetë tani është prej 60 euro ka qënë në bazë të shpenzimeve që bartin studentët në konvikte dhe menzen e studentëve, tani ka zbritur ajo, dhe ne me zbritur atë mund të ju ndihmojm me shumë studentët. Vetëm se pari duhet të ndryshohet rregullorja. Shuma e parave që është parapar për këtë vitë ajo nuk mund të ndryshohet pasi që është e parapar në buxhetë.

Zenel Shatri, LDK - propozimi im për ndryshimin e Rregullores është edhe kjo sepse është numri i vogël i përfituesve të bursistve, të jetë bursa 50 ose 40 euro dhe rritet numri i bursiatve.

Naim Imeraj, AAK - besoj që iniciativa me ndryshuar këtë Rregullore është me vendë por mirë është që në të fillojmë me punën sipas rendit të ditës siq është sot. Në Komisionin e zgjedhur të përfshihet përvoja në punën e Komisionit.

Kryesuesi - kërkon propozimet nga anëtaret e Kuvendit për këto komisioni,  
Komisioni për vlerësimin e bursave,  
Komisioni paraprak ka pasur 5 anëtar,

Kryetari i Komunës - sqaron freth Komisionit në bazë të Rregullores.

Të dy komisionet kanë përbërje prej 5 anëtaresh, në komisioni vlerësuese të bursave 3 anëtar përzgjedhin nga Kuvendi 1 nga ekzekutivi që është drejtori i Arsimit dhe 1 nga shoqëria civile, ndera të komisioni për ankesa kemi 2 anëtar nga Kuvendi 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.

Naim Imeraj AAK - AAK-ja propozon profesor z. Muhamet Ukaj, për vlerësimin e bursave.

Haki Podrimja LDK - në KPF e kemi propozuar një qelës që 3 anëtar nga Kuvendi të jenë nga patrit me të mëdha në kuvendë dhe kemi len që në këtë mbledhje të epen emrat.

Kryesuesi - rekomandimet e Komitetit kanë qenë që në komisioni për ndarjen e bursave të jetë 1 anëtar nga LDK 1 anëtar nga AAK dhe 1 nga PDK dhe drejtori i drejtoritë të Arsimit dhe një nga shoqëria civile, ndërsa për komisionin e ankesave 1 anëtar nga LDK dhe një nga VV, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.

Lulzim Shoshi PDK - emrin do ta keni një ditë tjetër.

Agron Avdija VV - a duhet të botohen këto emra, nuk e di pse po e kini kaq të vështir të caktioni dikën besoj që i keni menduar me herëtë këto, këtu duhet të jenë persona me profesional të ati profesioni.

Lulzim Shoshi PDK - ju koleg i nderuar nuk keni pse të ndërhytin në mendimet tona.

Arif Elshani IQ - ne muajin e kaluar duhet të procedojmë prapa me emrat e Komisionit.

Zenel Shatri LDK - propozon që në emr të grupit të LDK-së të jetë z. Naim Behluli.

Kryesuesi - Kuvendi mori vendim që në komisioni për bursa të jetë Naim Behlulin LDK, Muhamet Ukaj AAK ndërsa PDK do ta sjellë emrin një ditë tjetër.

Komisioni për ankesa ju lutemi propozimet

**Radoš Repanović SL-** Nuk kemi pasur përkthim të pika 4 dhe kaloj pika për KKSB, pse të jetë përfaqësuar për. Mendja vetëm Radio Fontana në kemi edhe një radio lokale tjetër dhe është e licencuar Radjo Bravo dhe Propozoj që të jetë përfaqësuese.

Kryetari i Komunës - këtë këshill ftohen edhe njerëz që nuk janë anëtar mund të marrin pjesë, dhe sa herë që do të ketë mbledhje mund të marr pse dhe ajo radio nuk ka ndonjë problem.

**Radoš Repanović SL-** të jetë anëtare dhe kjo radio.

Kryesuesi - Vazhdojmë për komisionin për ankesa po ashtu nga 5 anëtar, 2 nga kuvendi,

Zenel Shatri LDK- propozon nga grupi i LDK-së të jetë Valbona Demaj.

Agron Avdijaj VV -propozon që Lavdie Bujupaj të jetë nga VV.

Kryesuesi - kemi edhe 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.  
Ata emra do ti kemi me pas.

Miratohen këto propozime nga anëtaret e Kuvendit.

**Hedh në votim këtë Përbërje:**

**1 anëtar nga LDK 1 anëtar nga AAK dhe 1 nga PDK dhe drejtori i drejtoritë të Arsimit dhe një nga shoqëria civile, ndërsa për komisionin e ankesave 1 anëtar nga LDK dhe një nga VV, 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile**

**Miratohet me 22 vota për asnjë kundërte**

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.15/2018	Data: 29.03.2018	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen e Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 5) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10. dhe nenit 5 , neni 7dhe neni 9 të Rregullore për ndarjen e bursave për student Nr. 02/2017, në mbledhjen e mbajtur më: 29.03.2018 mori këtë:

**V E N D I M**  
**FORMIMI I KOMISIONIT PËR NDARJEN E BURSAVE**

1. Formohet Komisioni për ndarjen e bursave për student, në këtë komision emërohen këta anëtar:

1. Agim Haxhiu, Drejtori i Drejtoratit për Arsim dhe Kulturë,
  2. Naim Behlulaj, nga radhët e LDK-së anëtar,
  3. Muhamet Uka, nga radhët e AAK-së anëtar,
  4. Labinot Aliaj, nga radhët e PDK-së anëtar,
  5. Fabjan Ferizaj, nga shoqëria civile anëtar.
2. Komisioni i cekur më lartë, do të bëjë përzgjedhjen e studentëve për ndarjen e bursave ky komisionit vlerësues do të kryej të gjitha punët e caktuara me rregullore dhe ligj.
  3. Obligohet Drejtori për Arsim që ti kryej të gjitha punët administrativo – teknike të domosdoshme për komision.
  4. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tije në ueb faqen e komunës.
  5. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: anëtarët e grupit, MAPL-ja, shërbimi për punë të kuvendit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

**KRYESUESI I KUVENDIT,**  
**z. Qaush Balaj**

 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
	01 Nr.15/2018	Data: 29.03.2018	

Kuvendi i Komunës në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për vetëqeverisjen e lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 5) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10. dhe nenit 10 Rregullore për ndarjen e bursave për student Nr. 05/2015, në mbledhjen e mbajtur më: 29.03.2018 mori këtë:

**V E N D I M**  
**PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR ANKESA TË BURSAVE**

1. Formohet Komisioni për shqyrtimin e ankesave ndaj komisionit vlerësues të ndarjes se bursave, në komision emërohen:

1. Valbona Demaj, nga radhët e LDK-së kryesuese,
2. Lavdije Bujupi, nga radhët e VV, anëtare,
3. Edona Bujupi Loxha, nga ekzekutivi, anëtare,
4. Fazli Stollaj, nga ekzekutivi anëtar,
5. Sadik Fetahaj, nga shoqëria civile anëtar.

6. Komisioni i cekur më lartë, do të bëjë shqyrtimin e ankesave ndaj komisionit vlerësues lidhur me kërkesat e ofertuesve dhe do të bëjë rekomandimin e tyre në Kuvendi dhe do të kryej të gjitha punët e caktuara me rregullore dhe ligj.
7. Obligohet Drejtori për Arsim që ti kryej të gjitha punët administrativo – teknike të domosdoshme për komision.
8. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tije në ueb faqen e komunës.
9. Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: anëtarët e grupit, MAPL-ja, shërbimi për punë të kuvendit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

**KRYESUESI I KUVENDIT,**  
**z. Qaush Balaj**

### **Shqyrtimi i pikës 7**

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me pikën e shtatë të rendit të ditës, Marrja e vendimit për formimin e komisionit vlerësuese për dhenjën e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim dhe formimin e komisionit për ankesa.

Nënkryetari i Komunës- bënë sqarimin e këtyre komisioneve, komisioni vlerësuar përbëhet nga 7 anëtar 3 nga Kuvendi 3 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile. 3 anëtarë e Kuvendit janë rekomanduar nga KPF-ja që të jenë 1 nga LDK, 1nga AAK, dhe 1 nga PDK.

Ndërsa komisioni për ankesa përbëhet nga 5 anëtar dhe 2 nga Kuvendi 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.

Arif Elshani IQ- këto komisione të diriguara në Kuvend nuk i bëjnë shumë ndër Kuvendit duke marrë parasysh se të gjitha këto komisione formohen dhe dirigohen LDK, PDK, AAK, këtu ka anëtar të Kuvendit edhe tjerë që ndoshta e kanë vullnetin të kontribuojnë vetëm grupi jonë e ka me tepër se 10% ketë Kuvend, mendoj se edhe në tjerët mund të kontribuojmë, prej të gjitha këtyre komisioneve shihet është vetëm një komision VV për ankesa ndaj bursave.

#### **Kuvendi komunal më 25 vota për dhe 2 kundër vendosi:**

**Që komisionit vlerësuese për dhenjën e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim të ketë përbëhet nga 7 anëtar 3 nga Kuvendi 3 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile. 3 anëtarë e Kuvendit janë rekomanduar nga KPF-ja që të jenë 1 nga LDK, 1nga AAK, dhe 1 nga PDK, ndërsa komisioni për ankesa të ketë përbërjen preje 5 anëtaresh 2 nga Kuvendi 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile.**

**Miraton me shumicë votash.**

12 Pr	 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosovo	KUVENDI I KOMUNËS SKUPŠTINA OPŠTINE MUNICIPAL ASSEMBLY		 Komuna e Istogut Opština Istok Municipality of Istog
		01 Nr.15/2018	Data: 29.03.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008), nenit 8 të Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, Nr. 04/L-144. Dhe nenit 2 paragrafi 4 të Rregullores së QRK-së nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 29.03.2018, mori këtë:

**V E N D I M**  
**FORMIMI I KOMISIONIT VLERËSUES PËR DHËNIEN NË**  
**SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME KOMUNALE**

1. Formohet komisioni për vlerësues e dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, ky komision ku mandati i tij do të zgjatë sa mandati i Kuvendit.
2. Ky komision përbëhet nga këta anëtarët:
  1. z. Selidin Bytyçi, nga radhët e LDK-së kryesuese,
  2. znj. Jehona Haxhijaj, nga radhët e AAK-së anëtare,
  3. znj. Mirushe Sadikaj, nga radhët e PDK-së anëtare,
  4. znj. Valbona Kaliqani, nga shoqëria civile anëtare,
  5. z. Jashar Blakaj, Drejtor i Zhvillimit Ekonomik,
  6. z. Enver Rugova, Drejtor i Drejtoratit për Shërbime Publike,
  7. z. Isa Hoxhaj, Drejtor i Drejtoratit për Urbanizem Kadaster dhe Mbrojtje të Mjedisit.
3. Komisioni i cekur do të bëjë hapjen e të gjitha ofertave të kompanive të cilat ofertojnë për marrjen e pronave komunale në shfrytëzim, do të bëjë vlerësimin e të gjitha ofertave ekonomikisht më të favorshme të ofertuesve të cilët kanë konkurruar do t'i zbatojë të gjitha procedurat që kanë të bëjnë me dhënien e patundshmërive përmes ankandit publik të përcaktuara në Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, Nr. 04/L-144 dhe Rregulloren e QRK-së nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës si dhe do t'i kryejë edhe punët dhe detyrat të tjera të cilat janë në natyrën e komisionit.
4. Të gjitha punët administrativo-juridike dhe përkrahjen për Komisionin do t'i kryejë Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
5. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tije në ueb faqen e komunës, dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, MAPL, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtorati për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

**KRYESUESI I KUVENDIT,**  
**z. Qaush Balaj**

 <b>Republika e Kosovës</b> <b>Republika Kosovo</b> <b>Republic of Kosovo</b>	<b>KUVENDI I KOMUNËS</b> <b>SKUPŠTINA OPŠTINE</b> <b>MUNICIPAL ASSEMBLY</b>		 <b>Komuna e Istogut</b> <b>Opština Istok</b> <b>Municipality of Istog</b>
	01 Nr.15/2018	Data: 29.03.2018	

Kuvendi i Komunës, në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 pika d) dhe nenit 40 paragrafi 40.2 pika e) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovë, nr.28/2008) dhe në pajtim me nenin 33. Paragrafi 33.1. pika 5) të Statutit të Komunës 01 Numër 62/10, nenit 9 paragrafi 4 i Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, Nr. 04/L-144 dhe nenit 3 i Rregullores së QRK-së nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 29.03.2018, mori këtë:

**V E N D I M**  
**FORMIMI I KOMISIONIT PËR ANKESA**

6. Formohet komisioni për ankesa ndajë dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, me afat kohor sa mandati i kuvendit.
7. Anëtarët e komisionit janë:
  7. znj. Besa Ferati nga radhët e LDK-së Kryesues,
  8. z. Eliot Kukiqi, nga radhët e AAK-së, anëtsr
  9. z. Lulzim Shoshi, Drejtor i Drejtoret të Bujqësisë dhe Pylltarisë,
  10. z. Hysni Maxharri, Drejtor i Drejtoret për Buxhet e Financa,
  11. z. Nazmi Hasanaj, nga shoqëria civile anëtar.
8. Komisioni i cekur do të bëjë shqyrtimin e të gjitha ankesave brenda tridhjetë ditëve, ku do t'i kryejë punët dhe detyrat të tjera të cilat janë në natyrën e këtij komisioni komisionit në pajtim me Ligjit për Dhënien në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme Komunale, Nr. 04/L-144 dhe Rregulloren e QRK-së nr.23/2013 për Përcaktimin e Procedurave të Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbimit të Pronës së Paluajtshme të Komunës.
9. Të gjitha punët administrativo-juridike dhe përkrahjen për Komisionin do t'i kryejë Drejtoreti për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.
10. Ky Vendim hynë në fuqi shtatë ditë pas publikimit të tije në ueb faqen e komunës, dhe për zbatimin e tij do të kujdeset Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit.

Me kopje të këtij Vendim të njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, Drejtoreti për Urbanizëm, Kadastër dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe një kopje në arkivin e Kuvendit.

**KRYESUESI I KUVENDIT,**  
**z. Qaush Balaj**

Kryesuesi – lutë anëtaret e Kuvendit që ti japid emrat.

Naim Imeraj AAK- nga grapi i AAK-së do të jetë Jehona Haxhiaj.

Ajshe Metaj PDK - nga grapi i PDK-së propozon Mirushë Sadikaj.

Zenel Shatri LDK - nga grapi i LDK-së propozon Selajdin Bytyqi.

Kryetari - propozon Drejtorin e Urbanizmit Kadastrës Dhe Mbrojtje Të Mjedisit, Drejtorin E Zhvillimit, Drejtori I Shërbimeve Publike.

Kryesuesi - u formua komisioni vlërsueal është komision që zgjat sa mandati i Kuvendit Komunal.

Vazhdojmë me Komisionin për ankesa.

Ka përbërje prej 5 anëtarëshe 2 nga kuvendi,

Haki Podrimja LDK- propozon Besa Ferati nga grapi i LDK-së.

Naim Imeraj AAK - propozon Eliot Kukiqi nga grapi i AAK-së.

Kryesuesi - kemi 2 nga ekzekutivi dhe 1 nga shoqëria civile të cilat do ti kemi se shpejti.

## Shqyrtimi i pikës 8

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me pikën e tetë të rendit të ditës, Shqyrtimi i raportit përfundimtar financier për vitin fiskal 2017.

Osman Sadikaj, zyrtar Kryesor Financiar - bënë prezantimin dhe sqarimin e raportit përfundimtar financier për vitin fiskal 2017.

Arif Elshani IQ- në kemi marr një raport financier ku ky raport ndryshon me raportet tjera, kjo është hera e pestë për mua e këtij raportimi por ky raport është me i çuditshëm. Shihen qartë pagat dhe mëditje, shpenzimet komunale, mallra dhe shërbimet si dhe shpenzime kapitale në vitin e kaluar kemi shpenzuar dy miljen e shtatëdhjetë minë ku kemi pasur të alokuar plus gjashtëqind e katër dhjete mi ku nuk kemi arritur ti shpenzojmë, pse nuk janë shpenzuar ato dikush do të na tregojë, mendoj që ka pasur vend me u shpenzuar kanë mundur të shpenzohen për zgjedhjet, kemi shpenzuar vetëm 2miljon e sh ta dhjetë mijë ku kemi pasur 2miljon e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë, 64mijë euro kanë mbetur të pa shpenzuara, mallra dhe shërbime është e njëjta gjë si vitin e kaluar. Kemi shpenzimet e udhëtimit brenda vendit, kemi shpenzimet të udhëtimeve zyrtare jashtë vendit 13 mijë, shpenzimet kontraktuese 79 mijë, mobile, kemi pajisjet tjera 38 mijë, furnizim për zyre 104mijë, nafte për ngrohje qymyr, dru, mirëmbajtje të automjeteve 30 mijë etj.

Shpenzimet kapitale, kush ka marrë tenderi dua të di ueb faqja është mbyllur kemi hartuar 2miljon e 70mijë euro. Shpenzimet kapitale nuk ka asgjë. Kemi ramje të hyrat vetanake. Do të shkoj në KRPP të marrë këtë.

Osman Sadikaj - sqaron pjesën teknike të tabelat svaruese, parat siç thatë që kanë qenë të alokuar nuk kanë qenë një pjesë ka qenë e alokuar nga Grandet qeveritare 200mijë euro që kanë shkuan në suficit por jo 640mijë, 37mijë euro mëditje për udhëtime zyrtare ky është problem të cilin Ministria e Financave Departamenti i Thesarit nuk e ka hapur një kodë për transportin e nxënësve këtë ua kam svarua për çdo vite 37mijë euro është transporti i nxënësve sipas rregullës, 13mijë euro mëditje jashtë vendit është e vërtete, shpenzimet kapitale i kamë qit ashtu siç e thotë ligji. Pos kësaj që është në raport kusht që dëshiron diçka shtesë mund të me kërkon do tua jap, por në raport janë të raportuara sipas ligjit të gjitha.

Nënkyetar i Komunës - sqaron se ueb faqja e komunës ka pasur disa ndryshime nga MAPL-ja brenda këtij muaji është lëshuar, është dizajn i ri i cili është i njëjtë për të gjitha Komunat e Kosovës dhe në jemi duke bartur shënimet nga ajo ueb faqe në këtë.

Naim Imeraj AAK- në raport kemi mangësi për dy a tre mujore në njërin mund të kemi arsyetim për shkak të shpërbërjes së mandati të Kuvendit të kaluar, mirë po besoj që tremujori i katërt ka mundur të raportohet ka qenë edhe obligim ligjor me u raportuar. Formati i këtij rapporti që na u është paraqitur këtu është i ashtuquajturi pasqyrat financiare, a ka qenë obligative me na u dhënë pasqyrat financiare në Kuvend apo s'ka qenë obligative a ka ndryshuar diçka, pas që i kam kërkuar shumë na janë dërguar pastaj vetëm një herë.

Zyrtari kryesor financier dhe Nënkyetar ishin preciz në të përgjithshme.

Nëse e marrim komplet buxhetin shfrytëzimi është 90% apo 90,1% ndërsa nëse i hekur pagat jemi në 80% në shfrytëzim të buxhetit. Të argëtuar apo të pa arsyetuar këto shifra nuk na bëjnë me u ndih mirë 20% e buxhetit kthim në suficit apo mos grumbullim është një rastësi se edhe kur e krahasojmë inkasimin e të hyrave vetanake po na del aj 80%, shihet se ka qene një ngecje e cila ka reflektuar.

Nuk duket mirë 76,3% i shpenzimeve kapitale.

Të shpenzimet kapitale rrëthoja e ka marrë 10 % të buxhetit të komunës 208mijë euro të shpenzuara kjo është 535% e planifikimit kërkoj përgjegjës nga kompetentë si është e mundur me u tejkaluar në atë masë buxheti dhe mbi cilën bazë. Nuk jam i kënaqur me përgjigjen që kemi pasur planin shumë të lartë se në me mbërrit atë të vitit të kaluar atëherë kishim mundur të ankokemi që ka qenë i lartë ky plan i këtij viti por në nuk i kemi mbërrit as ato të viti të kaluar në me të hyrat vetanake nuk jemi as në nivelin e votim 2015 ë vitin 2017 kështu që ka që ka qene planifikimi i lartë por diçka ka ndodhur 55mijë euro borxhe prej lejeve të ndërtimit deri kurë do të kemi kësos lëshime në raport me investitorët të cilët bëjnë ndërtesa. Është fatkeqësi me shkua në suficit kaq shumë. Pse është vonuar procedura e bartjes së mjeteve në e dimë se gjithnjë është bërë bartja e mjeteve para raportimit. Borxhet shpenzimet kontingjente qenkan padit, astroniku 62mijë euro si u mblodhën këto dhe pse po e padit Komunën për 62 mijë euro. Masa e borxheve të këtij viti dhe të vitit të kaluar del që sivjet kemi me pak borxhe se sa vitin e kaluar tanë po e shohë prej pasqyrave financiare. Asfaltimi i rrugës borxh ku është problemi pse

borxh rruga. Drekat zyrtare borxh përafërsisht edhe 16 mijë euro a kanë pasur arsyetim, komunalit hynë të hyrat vetanake.

Këtu epet numri i punëtoreve në mungesën e punëtoreve janë zëvendësuar me kontrata mbi vepër, ku është shkaku pse janë shkuar mjetet në suficite të dihet nga numri me i madh i planifikuar apo ka arsyet tjetra.

Nënkyetari i Komunës - Sqaron rrathë borxhit të rrugës projekti ka qenë i planifikuar ky është me participim me komunitetin punë kryesi i ka kryer punët më afat të caktuar por është vonuar me sjelljen e faktuarës e ka sjellur fakturën me vonesë dhe nuk ka mundur të hy në sistem të pagesës dhe si i tillë është hy si borxh mjetet kanë qenë të zotuar të planifikuara.

Të komunalit e kemi problemin kryesorë kurë po bëhen daljet buxhetore të komunalit po kemi pak mjet në çdo dit jemi dëshmitar po zgjerohet rrjeti i ndriçimit publik dhe ndërtimeve publike dhe po duhet menjëherë të paguhet rryma pasi që KEDS po e ndërpren menjëherë dhe kjo kategori duhet të bëhet pagesa me bartjen e mjeteve.

Osman Sadikaj - në marrëveshje me Kryetarin kemi dashur që para jush ta bimë një raport me detal jashtë pasqyrave financiare siç e keni pasur po me diskutimin që kam bërë me Ministrin e Financave në jemi të obliguar ta zbatojmë Ligjin mbi Menaxhimin e Financave Publike obligimet që rrjedhin nga neni 46 dhe 46.1.

Në me herët kemi dhen një raport i cili ka qenë shumë me i detajuar e kemi zbatuar obligimin ligjor ta bëjmë të qartë çështjen e pasqyrave të audituara ku çdoherë kanë qenë të prezantuara para jush me rekomandime të auditorit.

Të pjesa e rrethojë është kod ekonomik zyrtari zotuese i cakton kodin ekonomik ku donë me i zotu kjo është standart i kontabilitetit ndërsa në kuadër të kësaj rrethojë janë projektet se ku kanë shkuar mjetet mund të ua dërgoj me imell çka është bëre. Të hyrat vetanake e përmend lejet e ndërtimit i ka më marrë informatën nga të gjithë kurë e kam plotësuar pasqyrat financiare këto kanë qene borxhe të me hershme.

Bartja e mjeteve është vonuar sepse Ministria e Financave par një javë na ka prurë zyrtarisht që në nuk kemi mundet ta qesim si pikë të rendit të ditës do ta kemi në mbledhjen e ardhshme si pikë të rendit të ditës.

Lista e borxheve duke e krahasuar me kohën si ka qenë fushat zgjedhore shpenzimet të cilat nuk është dashur të bëhen më përkrahjen e kryetarit dhe të nënkyetarit nuk kemi lejuar të shpenzohen mjetet që nuk duhet të gjitha këto në listën e borxheve që i kemi shpenzuar këto janë të pagueshme paguhen nga buxheti i këtij viti. Mundë të me shënoni çdo gjë që dëshironi ndonjë informatë rreth buxhetit në imellë.

Naim Imeraj AAK - prapa po kthen tek rrethoja e kam të pa qartë nëse në buxhet final kanë qenë të evidentuar me shumë dhe janë dal si shpenzim 535% si shpenzim përmu është e pakapshme logjikisht nëse me buxhet kanë qenë të planifikuara 39mijë e janë shpenzuar 208 mijë prej tyre 170 mijë nga të hyrat vetanake a ka mundësi të di a është anomali a është gabim apo një diçka që ka dal ashtu.

Osman Sadikaj - planifikimi nuk është në pasqyrat financiare janë vetëm shpenzimet aty.

2017 ka qenë viti i parë si eksperiment i Ministrisë së Financave të bëjë ndarjen buxhetore sipas kodeve ekonomike. Kur e kemi bërë ndarjen buxhetore nuk e kemi bërë

konfirmo kanë ber në lloj orientimi formal, në kemi pasur problem edhe gjatë shpenzimit të buxhetit duke u bazuar në këtë problem të gjithë Kryetarët e komunave kanë bërë presion në Ministrinë e Financave në 2018 me nuk alokohen sipas kodeve ekonomike, por ndahen si kategori ekonomike. Me një vendim janë shpenzuar sipas këtij kodi ky është viti i vetëm që ka ndodhur, por tani në vitin 2018 nuk është me e kanë hekur. Asgjë nuk kemi dashur të fshehim këto do të jenë në ueb faqe.

**Kuvendi komunal në mënyra anonime vendosi:**  
**Që raporti finançiar për vitin fiskal 2017,**  
**Miraton unanim.**

**Shqyrtimi i pikës 9.**

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me piken e nëntë të rendit të ditës, Anulimi i vendimeve të Kuvendit të komunës me numër, 01Nr.65/2017, 01Nr.66/2017, 01Nr.67/2017, dhe 01Nr.68/2017 të datës 05.05.2017.

Nënkyetar i Komunës - sqaron rreth anulimit të vendimeve.

Arif Elshani IQ - është e vetët që kemi të bëjmë me vendimet e datës 05.05.2017 të cilat në mënyre urgjente keni kërkuar që ti aproponi edhe pse ka shumë anëtar të Kuvendit që kanë kundërshtuar atë me arsyetimin e vetëm pse këto duhet të bëhen më shpejtësi kemi kërkuar të dihet çka do të bëhet me ato parcela është bërë deri sot dhe me tutje. Duhet të anulohen këto por nuk duhet të ngutjeni me marrjen e vendimeve tjera, sepse këto janë vendime të ngutshme për Kuvendin.

Naim Imeraj AAK - e dimë që ka qenë të e nxeh të e prillit dhe javës së parë të majit të vitit të kaluar dhe e dimë cilat rrjedha kanë paraprirë e kanë pamundësuar 4 pikat e rendit të ditës të caktuara veç e veç vendimet të cilat po citohen sot si të deklarime si të ndër lidhshmëri prej Ministria linjës kompetente për të shqyrta ligjshmërinë dhe e dimë që është mbajtur një mbledhje me përbërja të cunguar që ka pasur korin që ka nxjerr 4 vendime me 4 pika të rendit të ditës si vazhdim i asaj mbledhje dhe vendimet kanë shkuar si të tilla vërejtjet tona të asaj kohe kanë qenë që përgatitja profesionale përgatitja juridike e Vendimeve nuk ka qenë e plotë dhe si e tillë e ka më përdorur termin që nuk janë gabime teknike por janë gabime taktkive. Ministria i ka kthyer ato vendime dhe në jemi aj organ i cili duhet me vlerësuar edhe duhet të na jepni mundësin me e vlerësuar pse e kemi bërë atë gabim që mos të bimë në lajthitet e njëjtë me bë diçka e cila është kundër ligjore. Është dashur ekzekutivi që të na Pasi me material që të anulohen atë vendime nuk kemi asnjë një informacion tjetër pos vendimeve që të anulohen, mund të procedohej por kjo nuk është në rregull unë nuk kam qene që të miratohen këto vendime në formën që ka shkuar. Nuk po shohë as një dokument pse po anulohen këto vendime.

Nënkyetar i Komunës – komuna është njësi themelore e pushtetit lokal dhe vendimet e komunës ligjërish me çdo normë juridike nuk mundë të i anuloj askush përveç gjykatës kompetente e cila është kompetente për interpretimin e ligjeve në Kosovë sipas kushtetutës dhe ndarjes së pushtetit. Ministria e Administrimit të Pushtetit lokal jepe

mendime. Ju kam drejtuar me shkresë MAPL-së pas marrjes së vlerësimit ose mendimit profesional nga Ministria e Planifikimit Hapësinor që këto ngastra kadastrale të cilat ne sipas procedurave i kemi shpallë në ankand për dhenjën e tyre në shfrytëzim nuk janë park nacional dhe as një përgjigje nuk kamë marrë si të tilla për ti hapur rrugë zgjedhjes. Kërkoi nga ju që të anulohen këto vendime, për shkak që ka kaluar një kohë e gjatë dhe nuk kemi mundur të zbatojmë, ku edhe me ligj përcaktohet kur kalon afati kohor të njëjtat nuk mund të procedohen me tutje përmes ankandit publik andaj aj vendim duhet të anulohet.

Naim Imeraj AAK- nuk është ndonjë problem të hyhet në websaid të MAPL dhe me par së në raportin e punës së gjashtë majorit të parë të vitit të kaluar janë të precizuara si vendime të kontestuara të cilave ju ka kontestuar ligjshmëria si vendime të tilla sot i kemi me pretendimin që të anulohen, nuk kamë diçka kundër vetëm po dua të jem transparent deri në fund me ditur, që diçka që del nga ky kuvend mos të mbetet peng i përgjegjësive tona dhe obligimet për të cilat edhe jemi betuar. Sa e di në atë raport nuk ceket vetëm MAPL por si Ministri e linjës kontestuese për ato vendime ceket edhe Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural me intereson edhe kjo sepse jemi duke i anuluar 4 vendim e prej të cilave tri sot po na kthehen me një formë kontenzume ndërsa një vendim prej tyre nuk dihet fati i tije se a është kontestuar apo ka kaluar apo nuk ka qenë kompetence e jona të jemi transparent.

Arif Elshani IQ – e dëgjova Nënkyetarin shumë mirë kanë dhëne dorëheqje anëtaret e kuvendit se me pas qenë ata e kishe kryer vjetë këtë punë nuk ke mundur ta përfundosh sepse nuk ke pasur anëtar të komisionit dhe menjëherë e ke sjellë sot, Naimi është hekur nga komisioni edhe Luli nuk ka dashur të vij atëherë dhe ju nuk keni mundur ta jepni.

Nënkyetari i Komunës - për hir të transparencës një pronë e cila është shpallur në ankand dhe e cila prape nuk do të shpallet arsyja është e evidentuar si e mirë e shtetit dhe për këtë pronë ka ardhur vlerësimi që me këtë pronë nuk menaxhon Komuna, prandaj nuk është pjesë e këtij vendimi që do të shqyrtohet pikën e ardhshme.

**Kuvendi komunal më 21 vota për vendosi:**

**Që Anulimi i vendimeve të Kuvendit të komunës me numër, 01Nr.65/2017, 01Nr.66/2017, 01Nr.67/2017, dhe 01Nr.68/2017 të datës 05.05.2017.**

**Miraton Anulimi me shumicë votash.**

**Shqyrtimi i pikës 10.**

Kryesuesi - propozon që të vazhdohet me pikën e dhjetëtë rendit të ditës, Marrja e vendimit për dhenjën në shfrytëzim afate shkurtër të pronës Komunale me ankand publik për njësit kadastrale. Nr.00256-2, Nr.00074-10, Nr.00074-7, Nr.00074-6, Nr.00074-11, Z.K Vrellë, dhe njësive kadastrale Nr.00028-95, Nr.00028-94, Nr.00028-93dhe Nr.00028-92, Z.K Cerrcë.

Nënkyetari i Komunës – prezanton dhe sqaron Propozim Vendimit për dhenjën në shfrytëzim afate shkurtër të pronës Komunale me ankand publik për njësit kadastrale. Nr.00256-2, Nr.00074-10, Nr.00074-7, Nr.00074-6, Nr.00074-11, Z.K Vrellë, dhe njësive kadastrale Nr.00028-95, Nr.00028-94, Nr.00028-93dhe Nr.00028-92, Z.K Cerrcë.

Naim Imeraj AAK – kërkon që nëse ka brena në sall ndonjë anëtar që ka konflikt interesit për shkak të procedurave kërkon që të largohet.

Kryesuesi – nuk e di nëse ka dikush konflikt interesit këtu, por nëse ka ju kisha lut me dal.

Nënkyetari i Komunës – asgjë nuk është e përcaktuar tani për tani ankandi do të jetë i hapur të drejt konkurrimi do të kenë të gjith qytetaret e Komunës së Istogut pa dallim.

Arif Elshani IQ – e gjitha kjo bëhet për parcelën 28-1 e cila është anuluar dhe ndahet në katër parcela me numër 0028,, bëhet fjalë për një parcelë e cila shfrytëzohet që 18 vite që as një here as inspektorati as Komuna nuk kemi ide se çka behet. Këtu kemi të bëjmë me një vendim që kemi tentuar ta kalojmë herën e kaluar e nuk kemi mundur tani duhet të kalohet. Mendoj që kjo është e jashtë ligjshme jam i bindur se pas 6 muajsh do ta kthejmë prapë këtu.

Agron Avdijaj VV – ne si VV e grisim si shqetësim dhe pse ka qenë e vonuar dhenja në ankand edhe pse po dihet se kush janë shfrytëzuesi e këtyre parcelave të cilat po pretendohet të dalin në ankand. Nga nënkyetari u përmend që pronat jepen në shfrytëzim bizneseve që të zhvillohet punësimi kjo jepe në përputhje me planin strategjik që ka si sektor kryesor zhvillimin e biznesit që njëri nder ta e konsideron edhe turizmin, bjeshkën e konsiderojmë si ku do të zhvillohet turizmi e këto prona kanë shkatërrimin e potentialit turistik. Ka dëme në afërsi të Vrellës ku banojnë njerëz shumë afër gërmimeve dhe janë të rrezikuar.

Nënkyetari i Komunës – nuk nënkupton dhenjë e pronës një personi kushdo qe e fiton ankandin duhet të ju nënshtrohet procedurave të dhënjes në shfrytëzim në bëze ligjore për lëmin të cilën aj do ta ushtrojë.

Kuvendi i Komunës Voton Propozim Vendimit për dhenjën në shfrytëzim afate shkurtër të pronës Komunale me ankand publik për njësit kadastrale. Nr.00256-2, Nr.00074-10, Nr.00074-7, Nr.00074-6, Nr.00074-11, Z.K Vrellë, dhe njësive kadastrale Nr.00028-95, Nr.00028-94, Nr.00028-93dhe Nr.00028-92, Z.K Cerrcë.

Miratohet me 13 vota për, 3 kundër dhe 6 abstenime.

Pasi që nuk pati diskutime të tjera, Kryesuesi shpalli të mbyllur mbledhjen e Kuvendit të Komunës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:20.

**Procesmbajtëse,**  
**Vjosa Hysenaj**



**Kryesues,**  
**Qaush Balaj**

